

**VENDIM**  
**Nr. 71, datë 7.2.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 825, DATË 7.10.2015, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË PROCEDURAVE PËR  
DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN, MBYLLJEN DHE FUNKSIONIMIN E  
INSTITUCIONEVE PRIVATE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, NË TË CILAT  
ZHVILLOHEN EDHE LËNDË FETARE APO KU MËSIMI ZHVILLOHET EDHE NË  
GJUHË TË HUAJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 4, 5 e 6, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Shkronjat “a”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 1, “c”, “e” dhe “ë”, të pikës 2, shkronja “b”, e pikës 3, shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 4, dhe shkronja “b”, e pikës 5, të kreut II, të vendimit nr. 825, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**